



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 23.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.05.2024 të parashtruar nga " INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve te KPSH-së dhe QPS-së " , Nr. i prokurimit- 632-23-11804-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-171-221, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K., e dt.20.05.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve te KPSH-së dhe QPS-së " , Nr. i prokurimit- 632-23-11804-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-171-221, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 13.05.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 13.05.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K., me dt.20.05.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e

objekteve-pastrimi i objekteve te KPSH-së dhe QPS-së “ , Nr. i prokurimit- 632-23-11804-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-171-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 23.05.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj lidhur me pagat e punëtorëve nuk qëndron, sepse Grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë ka deklaruar se pagesat e punëtorëve do të kryhen me dt.5 të muajit paraparak, pavarësisht mos pagesave të bëra apo vonesës nga Autoriteti kontraktues;

Data: 04.04.2024

PËR : Zyrën e Prokurimit - KOMUNA E GJAKOVËS

NGA : JV: " PASTRIME SILVIO" Sh.P.K & " PE-VLA-KU" Sh.P.K – Dega ne Kosove

DEKLARATË

Konzerciumi JV: " PASTRIME SILVIO" Sh.P.K & " PE-VLA-KU" Sh.P.K – Dega ne Kosove me numër unik identifikues: K91413010N dhe 810794463 :

Deklarojmë me vullnetin tonë të lirë dhe të plotë dhe se mbajmë përgjegjësi juridike për deklaraten e dhënë se pagat e çdo punëtori do të paguhen çdo here sipas kërkesës se dosjes se Autoriteti Kontraktues: Komunës se Gjakovës me datën 05 te çdo muaji paraparak edhe përkundër mos pagesës se bere apo te vonuar nga Autoriteti Kontraktues.

Deklaruesi :

JV: " PASTRIME SILVIO" Sh.P.K & " PE-VLA-KU" Sh.P.K – Dega ne Kosove

Bule Allwase
B



Pretendimi juaj se analiza financiare e Grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë e dorëzuar me dt.04.04.2024, ka një mospërputhje me atë të dorëzuar me dt.25.04.2024, nuk qëndron, sepse Autoriteti kontraktues përmes sqarimeve shtesë ka kërkuar nga Grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë që të zbërthejnë analizën financiare të dt.04.04.2024. Me dt.25.04.2024, Grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë, e ka sjellë të zbërthyer analizën financiare duke plotësuar kështu kërkesat e Autoritetit Kontraktues .

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

